



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE
MINISTRI

Nr. 1990 prot.
2

Tiranë, më 8.05/2020

URDHËR

Nr. 304, datë 8.05.2020

**“PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË URDHËRIN NR.279, DATË 25.04.2020
“PËR LEHTËSIMIN E POSAÇËM TË LËVIZJES NË “ZONAT E GJELBËRTA”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 7, të Ligjit Nr.15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga COVID-19, Vendimit të Komitetit Teknik nr. 225, datë 08.05.2020,

URDHËROJ:

Në Urdhrin Nr. 279 datë 25.04.2020 “Për lehtësimin e posaçëm të lëvizjes në “Zonat e Gjellbërta”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në pikën 1, pas fjalës “Vlorë” shtohen fjalët “Lushnjë, Patos, Roskovec, Korçë, Has, Kukës, Lezhë, Mirditë, Fushë Arrëz, Malësi e Madhe, Pukë, Vau i Dejës, Kavajë, Vorë, Rrogozhinë, Peqin”.
2. Në pikën 3, orari 17:30 zëvendësohet me orarin 21:00.
3. Pika 6 riformulohet si vijon:
“6. Lejohet lëvizja e mjeteve private, pa autorizim, vetëm brenda qarku ose bashkisë së zonave të gjellbërta, nga ora 09:30 deri në orën 21:00, vetëm me pasagjer anëtarët e familjes.”
4. Pas pikës 6 shtohet 6/1, me këtë përmbajtje:
“6/1 Aktivitetet e lejuara sipas përcaktimeve të bëra në udhrin nr 193 datë 20.03.2020 “Për mbylljen apo kufizimin e lëvizjeve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, për zonat e gjellbërta do të ushtrojnë veprimtarinë e tyre deri në orën 21:00”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ogerta Manastirliu

